

EMINE BAKALLI

QËNDRIMI I SHQIPËRISË NDAJ SANKSIONEVE TË LIDHJES SË KOMBEVE KUNDËR ITALISË FASHISTE (1935)

Kohë e sprovave të mëdha apo tragjikomedia rreth sanksioneve

Shqipëria vazhdoi të qëndrojë në fokusin medietik dhe diplomatik ndërkombëtar edhe pas fashitjes së temës lidhur me “kryengritjen e Fierit”¹. Këtë radhë çështja kishte të bënte me pozicionimin e saj ndaj vendimit të Asamblesë të Lidhjes së Kombeve për sanksione ekonomike kundër Italisë si ndëshkim për fillimin e agresionit ushtarak në Etiopi (3 tetor 1935)². Ky cep afrikan kishte mbetur jashtë zaptimit në finalen e madhe koloniale evropiane (fundi i shek. XIX-fillimi i shek. XX). Edhe pse dikur vetë Italia ishte angazhuar për pranimin e këtij shteti afrikan në këtë institucion ndërkombëtar, Benito Musolini asnjëherë nuk kishte fshehur synimet për ekspansion në këtë pjesë të Afrikës. Këto synime imperialiste, të përkrahura dhe nga garda e vjetër diplomatike italiane³, morën zhvillim të shpejtë dhe po konkretizoheshin pas Konferencës së Stresës. Në këtë konferencë, Italia dhe Franca të cilat tashmë kishin një marrëveshje⁴ së bashku me Britaninë e Madhe rikonfirmuan përkushtimin e tyre për ruajtjen e paqes në Evropë⁵. Në fakt, diplomacia italiane po e shfrytëzonte me mjeshtri interesimin e demokracive perëndimore për

¹ Për këtë shih: Emine Arifi-Bakalli, “Kryengritja e Fierit” si shkas i kthesës negative në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave”, në *Studime historike*, nr. 3-4, Tiranë: 2018.

² Owen Pearson, *Albania and King Zog, 1908-1939*, The Centre For Albanian Studies, London: 2004, f. 373.

³ Danis Mack Smith, *Musolinijevo Rimsko Carstvo*, Zagreb: Globus, 1980, f. 62; Grandi në cilësinë e ministrit të Jashtëm italian që në vitin 1930 kishte deklaruar misionin italian “për civilizimin e kontinentit të zi” (*po aty*, f. 69).

⁴ Vladimir P. Potemkin, *Historija Diplomacije III, 1919-1939*, Matica Hrvatska, Zagreb: 1951, f. 440.

⁵ Vinston S. Çerçil, *Drugi Svetski rat, Tom I, Bura se sprema*, Beograd: Prosveta, f. 123. Ministri i Jashtëm frëng Pier Laval lidhur me këtë qëndrim thoshte se “do të ishte fatkeqësi për tërë Evropën nëse ekspansioni italian të depërtonte në Ballkan, në shtetet danubiane apo në Lindjen e Afërt” (V. P. Potemkin, *Historia Diplomacije III 1919-1939 ...*, f. 458).

evitimin e formimit të një boshti nazifashist dhe për parandalimin e përplasjeve në Evropë. E megjithatë, kjo ndërmarrje italiane sado larg Evropës, vuri në sprovë gjithë diplomacinë botërore dhe vetë Lidhjen e Kombeve. Kjo sprovë u bë aq më e bezdisshme ngaqë doli se Etiopia në krye me negusin Haile Selas, nuk qëndroi duarkryq dhe rezistenca e saj zgjati deri në majin e vitit 1936.

Gjatë kësaj kohe, fuqitë e mëdha e të vogla dhe vetë Lidhja e Kombeve u bënë aktorë të një tragjikomedie⁶ apo të një yryshi të madh drejt një finaleje të mjerë. Rolin kryesor në këtë kuadër e kishte Britania e Madhe.

Në fillim, diplomacia britanike demonstroi përkushtim për zbatimin e standardeve të Lidhjes së Kombeve lidhur me çështjen në fjalë. Qeveria, parlamenti dhe shtypi me besueshmëri britanik (*Times*, *Daily Telegraph* etj.) u angazhuan kundër synimit italian ndaj Etiopisë. Një kohë madje u fol edhe për angazhimin e Britanisë për sanksione ushtarake, gjë e cila nuk kishte gjetur aprovim nga diplomacia frënge⁷. Lajmet sipas të cilave, Britania dhe Franca kishin arritur ujdin që çështja e Etiopisë të zgjidhej me ndarjen e këtij shteti midis palëve të involvuara në konflikt shkaktoi tronditje dhe reagim të paparë në opinionin britanik⁸. Aq më tepër kur sipas informacioneve të përfolura, prapa kësaj iniciative qëndronte Papati i Romës⁹. Duhet theksuar se lidhur me këtë trend në Britani merita të mëdha ka pasur një personalitet i fuqishëm dhe karizmatik, diplomati Entoni Idën (Anthony Eden). Ky ishte në krye të delegacionit britanik në Lidhjen e Kombeve dhe si brenda instancave të saj ashtu dhe në takime të shumta individuale, shpërfaqti përkushtim të plotë kundër agresionit italian. Eden-i nuk hezitoi të përdorë terminologji

⁶ Giuliano Procacci, *Historia e italianëve*, Tiranë: Toena & Shtëpia e Librit, 2000, f. 531. Këtë cilësim të çështjes së sanksioneve kundër Italisë e gjejmë te ky autor.

⁷ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë* (më tej: *AMPJ*), viti (më tej: V.) 1935, dosja (më tej: D.) 79, fl. 91, Gjenevë, 12 tetor 1935; *po aty*, fl. 72; *po aty*, fl. 69-72. Raport nga Londra: Sipas vendimit të Komisionit të Lidhjes së Kombeve për Koordinimin e Sanksioneve, këto do të shtriheshin në ndalesat e eksport-importit të materialit luftarak; po kështu rekomandohej ndalimi i operacioneve financiare dhe ato të kreditit me Italinë; ndalimi i importit të të gjitha mallrave të prodhuara apo dhe ato që vinin përmes Italisë e që ishin prodhime të ndonjë shteti të tretë; që të ndalohej dhe eksporti i disa artikujve që mund të hynin në funksion të luftës si minerale, gjë e gjallë tërheqëse etj., Londër, 13 tetor 1935.

⁸ *Arhiv Jugosllavije* (më tej: *AJ*), Fond: Milana Stojadinoviça, F-37, f. 57.

⁹ *Po aty*.

aspak diplomatike ndaj të gjithë atyre që ndiqnin taktika të caktuara në këtë rast¹⁰.

Por, në Britaninë e Madhe kishte dhe qarqe, të cilat e përkrahën ndërmarrjen italiane në Etiopi. Argumentet e tyre bazoheshin në prapambetjen e skajshme të këtij vendi ku ende ruhej sistemi i skllavërisë; pamundësia e Abisinisë që t'u përgjigjej standardeve të Lidhjes së Kombeve¹¹ etj. Madje, kishte tendenca që pushtimit italian t'i atribuonin misionin civilizues, kurse nga politika britanike ato kërkonin qëndrim neutral dhe heqjen dorë nga roli i "fuqisë policore në ruajtjen e paqes botërore"¹². Gjithandej, kishte interpretime se lufta në fjalë, ishte një rast i mirë që Britania të shiste armë, madje të dy palëve në konflikt¹³. Po kështu, kishte komente se mobilizimi dhe demonstrimi ushtarak britanik në Egjipt, më shumë kishte të bënte me synimet e këtij shteti për pavarësi se sa me çështjen e Etiopisë¹⁴. U përfol dhe se prapa angazhimit të sigurtë të Idenit dhe "parimësisë" së diplomacisë britanike në këtë rast, fshihej frika e saj nga konkurrenca italiane në atë pjesë të Afrikës¹⁵.

Në fillim u duk sikur Britania e Madhe do të qëndronte e palëkundur në pozicionin e saj fillestar. Por, shumë shpejt, diplomacia e saj theksoi mundësinë e shpërthimit të një lufte italo-britanike dhe u përqendrua në sigurimin e aleatëve potencialë në këtë rast. Çështja u shtrua në plan të gjerë dhe u trajtua sidomos me faktorët e rëndësishëm shtetërorë e rajonalë, të cilët gravitonin në Mesdhe (Franca, Jugosllavia, Turqia, Pakti Ballkanik etj.)¹⁶. Tanimë, diplomacitë e dy demokracive perëndimore [Britania e Madhe dhe Franca] theksin e diskutit diplomatik e zhvendosën nga përkrahja për Etiopinë në përkrahjen dhe

¹⁰ AMPJ, V. 1935, D. 79, fl. 127. Raport i Lec Kurtit, Gjenevë, 3 nëntor 1935.

¹¹ Po aty, V. 1935, D. 135, fl. 23. Raport i ministrit Fuqiptotë shqiptar në Britaninë e Madhe, 24 korrik 1935.

¹² Po aty, fl. 24.

¹³ Po aty, V. 1935, D. 79, fl. 50-54; po aty, V. 1935, D. 135, fl. 24. Raport i ministrit Fuqiptotë shqiptar në Britaninë e Madhe, 24 korrik 1935.

¹⁴ Po aty, V. 1935, D. 79, fl. 55. Raport i konsullit shqiptar, Aleksandri, 17 tetor 1935; po aty, fl. 57-58, Aleksandri, 1 tetor 1935; Madje në rrethet e kolonisë shqiptare atje të mbledhur rreth shoqërisë "Bashkësia" u fol për distancim të organizuar nga qëndrimi i Shqipërisë ndaj sanksioneve në mënyrë që të evitonin probleme eventuale me autoritetet britanike në Egjipt.

¹⁵ Po aty, V. 1935, D. 95, fl. 72-73. Raport i ministrit Fuqiptotë shqiptar në Britaninë e Madhe, Londër, më 30 maj 1935.

¹⁶ AJ, Fond: M. Stojadinovica, F-37, f. 57.

ndihmën reciproke në rast se ato bëheshin objekt sulmi¹⁷. Dhe e gjithë kjo, po ndodhte në kohën kur gjithandej po fuqizohej bindja se Italia, nuk do ta merrte veten as brenda një dekade nga lufta për Etiopinë¹⁸.

Krahas kësaj, u organizuan dhe bisedime tripalëshe (Britani, Francë, Itali) për mundësinë e zgjidhjes paqësore të “konfliktit italo-abisinas”. Madje, u fol për mundësinë e kthimit të Gjermanisë në Lidhjen e Kombeve përmes ringjalljes së marrëveshjes së Lokarnos¹⁹. Nga fundi i vitit 1935, Çembërleri hodhi idenë e një konvente ajrore midis katër fuqive perëndimore: Britanisë, Gjermanisë, Francës dhe Italisë²⁰. Në fakt, diplomacia evropiane tashmë po e vendoste theksin e veprimtarisë së saj në kombinimet politike për gjetjen e një rruge për të dalë nga “kriza e sanksioneve”.

Dhe, derisa në Etiopi po zhvillohej luftë e përgjakshme, Franca, Britania e Madhe dhe vendet që votuan për këto sanksione, praktikisht i harruan ato²¹. Po kështu, edhe fqinjët e Shqipërisë, Jugosllavia²² dhe Greqia²³, të cilat kishin raporte të dendura ekonomike me Italinë, ishin tejet të përkushtuara që aplikimi i sanksioneve të shtyhej sa më shumë. Kështu, përkundër bllokadës së shpallur Italia vazhdonte të furnizohej me naftë ndërsa kanali i Suezit nuk u mbyll asnjëherë për anijet e saj²⁴.

Sanksionet e shpallura ndaj Italisë fashiste nga ana e Lidhjes së Kombeve, ishin ndër veprimet e fundit në frymën e misionit të saj. Kurse, mënyra se si u zbatuan këto sanksione, apo më mirë heqja dorë nga to ende pa filluar zbatimin, ishte paralajmërim i qartë për të gjithë aktorët e kohës. Po fillonte epoka e politikave mbijetuese dhe sprapsjes para kërcënimeve agresive të së djathtës ekstreme evropiane.

¹⁷ *Po aty*.

¹⁸ *AMPJ*, V. 1936, D. 60, fl. 1-3, Raport i ministrit Fuqiptotë shqiptar në Greqi, Athinë, më 30 dhjetor 1935.

¹⁹ *Po aty*, V.1935, D, 79, fl.127. Raport i përfaqësuesit të Përhershëm të Shqipërisë pranë LK, Gjenevë, 3 nëntor 1935.

²⁰ *Besa*, Tiranë, 23 tetor 1935, f. 1.

²¹ André Maurois, *Histori e Anglisë*, Tiranë: Çabej, 1996, f. 228. Ky autor konstaton se këto sanksione “qenë të padobishme dhe Italia doli fitimtare në Luftën e Etiopisë”.

²² *Diplomatski Arhiv Saveznog Sekretariata Inostranah Poslova Jugoslavije* (më tej: *DASSIP*), Tursko Poslanstvo (më tej: TP), 1935, F-21, Nr. 486, Beograd, 28 tetor 1935.

²³ *AMPJ*, V. 1925, D. 79, fl. 118. Raport i ministrit Fuqiptotë shqiptar në Greqi, Athinë, 25 tetor 1935.

²⁴ G. Procacci, *Historia e italianëve ...*, f. 531.

Shqipëria në shënjestër

Shqipëria doli të ishte në mesin e shteteve më të angazhuar në rastin e sanksioneve të shpallura nga Lidhja e Kombeve. Prirja politike e Tiranës dhe interesi i saj afatgjatë nënkuptonte besnikëri ndaj Lidhjes së Kombeve-Statutit të saj, sipas të cilit parashiheshin masa mbrojtëse në rast të agresionit klasik ndaj ndonjë anëtari të saj (Neni 16). Por në anën tjetër, në Shqipëri ende nuk ishte përmbyllur kriza politike e verës 1935, ndërsa kriza ekonomike praktikisht po e çonte atë drejt kolapsit shtetëror. Shpresa e Tiranës se mbase qeveria e re jugosllave me Millan Stojadinoviçin në krye, mund të ndërmernte ndonjë hap për zbatimin e marrëveshjeve ekonomike të viteve 1933-1934, që nënkuptonte dhe përkrahje politike²⁵, ishte shuar përfundimisht. Ky ballafaqim ndodhi pas demonstrimeve dhe pozicionimit të Beogradit kundër kreut shqiptar dhe Shqipërisë, me rastin e kryengritjes së Fierit (gusht 1935)²⁶. Ndërkaq, Italia ishte shumë e interesuar për një pozicionim proitalian të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve. Në prag të fillimit të seancës së Asamblesë së Lidhjes së Kombeve²⁷, përfaqësuesi i përhershëm italian në Gjenevë Roko, dhe i deleguari italian Aloisi, organizuan një takim me përfaqësuesin e përhershëm shqiptar atje, Lec Kurtin. Këtij të fundit, iu bë e qartë se Italia priste nga Shqipëria votën kundër sanksioneve, ashtu siç bëjnë Austria dhe Hungaria. Madje, nga Kurti u kërkuar që vetë ky të deklarohej në emër të Shqipërisë në frymën e kërkesës italiane, sepse “përndryshe do të bëhej shkaktar i prishjes s’akordeve tona”²⁸. Natyrisht,

²⁵ Për këtë shih: Emine Arifi-Bakalli, *Marrëdhëniet ekonomike shqiptaro-jugosllave (1929-1939)*, Instituti i Historisë, Prishtinë: 1997.

²⁶ Shih: E. Arifi-Bakalli, “Kryengritja e Fierit” si shkas i kthesës negative...”. Prof. Arben Puto në librin *“Shqipëria politike 1912-1939”*, Tiranë: Toena, 2009, f. 534, konstaton se qëndrimi i Shqipërisë ndaj sanksioneve u bë shkak i ndërprerjes së bisedimeve (!-unë) me Jugosllavinë për aderimin e Shqipërisë në Paktin Ballkanik. Në fakt, çarja shqiptaro-jugosllave tashmë kishte ndodhur.

²⁷ *AMPJ*, V. 1935, D. 79, fl. 50-54. Lidhja e Kombeve, Sesioni i 49 i Këshillit të Lidhjes së Kombeve, Gjenevë, 7 tetor 1935.. Këshilli i LK me pajtimin e të dy palëve, asaj italiane dhe abisinase, vendosi që çështja të trajtohej nga Asambleja e LK e cila Italinë e klasifikoi si agresore.

²⁸ *AMPJ*, V. 1935, D. 79, fl. 91. Raport i përfaqësuesit të Përhershëm shqiptar pranë LK, Gjenevë, 12 tetor 1935; Madje Lec Kurtit iu premtua kompensim i mirë në rast se pranonte diversionin në lidhje me diplomacinë shtetërore shqiptare. Një mentalitet mafioz në politikën italiane.

Kurti e refuzoi këtë kërkesë dhe insistoi që të pritej ardhja e delegacionit zyrtar shqiptar. Kjo mënyrë e sjelljes nga ana e Aloisit, flet jo vetëm për nervozitetin dhe arrogancën e diplomacisë italiane por dhe për faktin se Italia, deri në çastin e fundit, nuk e kishte të qartë cila do të ishte vota e Shqipërisë.

Dhe në fakt, pikërisht në çastin e fundit qeveria shqiptare vendosi të distancohet nga sanksionet e shpallura kundër Italisë²⁹. Menjëherë pas këtij vendimi, kryesuesi i delegacionit shqiptar në Gjenevë, Mehdi Frashëri deklaroi më 11 tetor 1935, pamundësinë e qeverisë shqiptare “që të pranojë zbatimin e këtyre sanksioneve”³⁰. Qëndrimi shqiptar shkaktoi jo pak reagime në qarqet diplomatike. Ato nuk fshihnin habinë, që një shtet i cili shumë lehtë dhe shumë shpejt mund të gjendej në pozitën e Etiopisë, të sillej në këtë mënyrë³¹.

Natyrisht, diplomacia shqiptare, e ballafaquar me këtë reagim, zhvilloi një fushatë shfajësimi në përgjithësi e sidomos pranë shteteve me peshë dhe ndikim për Shqipërinë siç ishte Britania e Madhe dhe dy fqinjët e saj tokësorë: Jugosllavia dhe Greqia. Arsyetimi i diplomacisë shqiptare se përse Shqipëria “u shtrëngua” të bënte këtë hap, bazohej në faktorë të natyrës politike (Traktati i aleancës me Italinë i vitit 1927), ekonomike (eksport-importi shqiptar me Italinë, financat etj.) si dhe mundësia e izolimit “nga bota oksidentale” si në komunikacionin ajror, atë detar dhe telekomunikim. Krahas kësaj, diplomatët shqiptarë duhej të vinin në dukje faktin se Shqipëria do të mbetej konsekuente në mbrojtjen e pavarësisë së saj dhe në “relacionet miqësore me shtetet ballkanike”³². Nuk u la pa u përmendur dhe frika e Tiranës nga mundësia e ndonjë intervenimi italian në kuptimin e bombardimit apo ndonjë formë tjetër veprimi agresiv në rast të aprovimit të sanksioneve nga ana e saj. Për këtë

²⁹ Në telegramin informativ për trupën diplomatike shqiptare (11 tetor 1935) thuhej “Shqipnia tue marrë parasysh situatën e saj, traktatin e aleancës dhe sidomos lidhjet tregtare me Italinë u shtërngue të deklarohet kundër sanksjonevet në Asamblenë e Lidhjes së Kombeve dhe kjo për t’evitue një izolim të plotë të saj me botën oksidentale”.

³⁰ *AMPJ*, V. 1935, D. 79, fl. 113, Gjenevë, 20 tetor 1935. Ky qëndrim i Shqipërisë u ripohua dhe nga Lec Kurti më 19 tetor 1935 në kuadër të Komisionit Koordinues për sanksionet kundër Italisë. Prandaj pohimi i Paskal Milos se Shqipëria mori qëndrim neutral, nuk ka mbështetje.

³¹ *DASSIP*, TP, 1935, F-22, 1935/X. Raport mujor i MPJJ.

³² *AMPJ*, V. 1935, D. 79, fl. 67. Telegram udhëzues i ministrit të Punëve të Jashtme shqiptare, Xhafer Vila, Tiranë, 11 tetor 1935.

mundësi, qoftë si preventiv po dhe si reaksion në rast të dështimit italian në Etiopi, po përfliet jo pak në opinionin e gjerë dhe në qarqet diplomatike evropiane që nga vera e vitit 1935³³. Prandaj, një komponent i rëndësishëm i motivacionit të Tiranës për qëndrimin ndaj sanksioneve del se ishte qëllimi i saj që Romës t'i zhbëhej “preteksti” për ndonjë ndërhyrje ushtarake në Shqipëri.

“Ekspozeja” e Eqrem Vlorës - alarm apo mesazh për Beogradin?

Lidhur me trajtimin e çështjes së sanksioneve nga qeveria shqiptare mësojmë nga një raport³⁴ i legatës jugosllave në Tiranë, drejtuar personalisht kryeministrit dhe ministrit të Jashtëm jugosllav, Stojadinović. Raporti bazohet në një bashkëbisedim të ministrit fuqiptotë jugosllav në Tiranë, Gjonović me sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme shqiptare, Eqrem Vlorë. Ky titullar i lartë i shtetit shqiptar e pa të nevojshme që t'i shpalojë Beogradit shumë detaje të një mbledhjeje delikate të qeverisë shqiptare, menjëherë pas mbajtjes së saj. Natyrisht që Vlorë kërkoj diskrecion absolut lidhur me këtë “ekspoze”. Sipas tij, mbledhjen e qeverisë e kryesoi vetë mbreti “edhe pse foli fare pak”. Vlorë dhe ministri i Punëve të Jashtme Vila, në mbledhjen e qeverisë shkuan të bindur se aty duhej të konfirmohej vota e Shqipërisë për devotshmëri ndaj Lidhjes së Kombeve përkatësisht për sanksione kundër Italisë. Por, që në fillim të mbledhjes “u pa se mbreti kishte mendim të kundërt”. Xh. Vila aty-për-aty ndryshoi mendimin, gjë që Vlorën e habiti pamasë. Ndërkaq, ministri i Brendshëm, Musa Juka dhe ai i Financave, Abdurrahman Dibra mbajtën qëndrim krejt të rezervuar. Por, ministri i Bujqësisë Dhimitër Berati, u angazhua në “mënyrë të flaktë” që Shqipëria të mos pajtohet me sanksionet. I vetmi ndër të pranishmit që e kundërshtoi fuqishëm diskursin e Beratit, ishte Eqrem Vlorë.

Së pari, Vlorë shfaqti mendimin se vota për të mbështetur sanksionet do të kishte reperkusione në bilancin tregtar shqiptar, ky dëm ishte i papërfillshëm në krahasim me dëmin politik në rast të kundërt. Kjo

³³ Shih te E. Arifi-Bakalli, “Kryengritja e Fierit” si shkas për kthesën negative ...”.

³⁴ DASSIP, Londonsko Poslanstvo (LP), 1935, F-I, Arb. Nr. 1017. Raport i ministrit Fuqiptotë jugosllav në Shqipëri, Gjonović, drejtuar Kryeministrit Stojadinović, Tiranë, 16 tetor 1935.

sepse duhej pasur parasysh interesi që kishte Shqipëria nëse një ditë do të kishte nevojë për mbështetjen e Lidhjes së Kombeve. Në të kundërtën “vështirë se mund të llogaritej përkrahja e saj”.

Së dyti, sipas Vlorës pozita gjeografike dhe brishtësia e Shqipërisë, i impononte asaj një pozicion absolutisht neutral. Në këtë mënyrë, eliminohej preteksti i Italisë dhe i Jugosllavisë për ndonjë veprim ushtarak kundër saj. Prandaj, nëse Shqipëria në rastin konkret mernte anën e Italisë “Jugosllavia me të drejtë mund të ndërmernte masa për sigurinë e saj”. Kjo mund të iniciohej dhe veprime të ngjashme nga Italia, dhe ja konflikti nga i cili Shqipëria do të dilte gjithsesi humbëse. Në ç’kondita dhe kush mund ta largonte Italinë në rast se ajo dilte fituese dhe, në të kundërtën, në rast se fitonte Jugosllavia, “kush e di në çfarë kushtesh forcat e saj do të largoheshin nga Shqipëria”-e shtronte çështjen Vlora. Përmbledhtas, sipas tij, për një ndihmë të papërfillshme financiare po bëheshin “sakrifica të mëdha politike”.

Së treti, Shqipëria kishte tashmë tri vite që po zhvillonte një politikë emancipuese karshi Italisë në funksion të zhbërjes së reputacionit të “protektoratit italian” dhe varësisë financiare prej saj. Ky kurs i kishte kushtuar Shqipërisë shumë sakrifica por kishte patur dhe rezultate. Nëse Shqipëria rreshtohet haptazi në anën e Italisë sa i përket sanksioneve, do të treteshin të gjitha rezultatet e kësaj politike. Këtë hap të qeverisë shqiptare, Vlora e konsideronte si gabimin më të madh politik të Shqipërisë që nga themelimi i saj³⁵.

Si mund të interpretohet kjo “ekspoze” e Eqrem Vlorës drejtuar një përfaqësuesi të huaj i cili me aq pasion zhvilloi propagandë antishqiptare vetëm pak kohë më parë³⁶. Si përpjekje të një personaliteti shtetëror shqiptar për nxitjen e një ndërhyrjeje të Beogradit në Tiranë e më gjerë, në mënyrë që kjo të hiqte dorë nga ky pozicion i cili nënkuptonte kthesë

³⁵ *Po aty*.

³⁶ *Po aty*, LP, 1936, F-I, Arb. nr. 77. Letër cirkulare e ministrit të Jashtëm jugosllav-Stojadinoviq, Beograd, 26 dhjetor 1935. Prandaj, Mbreti Zog nuk e trajtoi fare çështjen e sanksioneve me J. Gjonoviq, edhe pse këtë e bëri, me ministrat Fuqiplotë britanikë dhe rumunë. Lidhur me deklaratat e Zogut për arsyet që kishin diktuar qëndrimin ndaj sanksioneve dhe për pohimin se ai do të vazhdojë me politikën e bashkëpunimit me shtetet ballkanike, Stojadinoviq konstatonte: “Këtyre deklaratave të mbretit Zog, kori diplomatik në Tiranë nuk iu beson shumë dhe konsideron se Zogu ka hequr dorë nga politika ballkanike dhe se sërish është lidhur me Italinë”.

të re drejt Romës, apo ndoshta si ofertë për një adresë më të sigurt³⁷ në Shqipëri, për bashkëpunim në mbrojtjen e Ballkanit nga synimet italiane.

Riaktualizimi i motos standarde politike të Beogradit: Shqipëria e “Ahmet Zogut” rrezik për paqen

Dy fqinjët tokësorë të Shqipërisë, Jugosllavia dhe Greqia votuan për sanksionet kundër Italisë. Natyrisht, diplomacia shqiptare e konsideroi të nevojshme që çështjen e pozicionimit shqiptar në këtë rast ta trajtojë me të dyja këto shtete. Ministri fuqiptotë shqiptar në Beograd, Rauf Fico, kërkoi takim në Ministrinë e Punëve të Jashtme jugosllave që më 11 tetor. Por pasi zëvendësministri i ri i Jashtëm Martinac “kishte qëlluar i zënë”³⁸, ky u prit nga drejtori i ri i sektorit politik të kësaj ministrie, Ivo Andriq. Në këtë takim, përveç argumenteve standarde, Ficoja theksoi fuqishëm se ky veprim i imponuar për Shqipërinë, në asnjë mënyrë nuk do të cenonte marrëdhëniet e mira dypalëshe dhe as përkushtimin e saj në ruajtjen e pavarësisë shtetërore³⁹. Andriqi përgjithësisht mbajti qëndrim të ftohtë dhe nuk la pa ia përkujtuar diplomatit shqiptar se Statuti i Lidhjes së Kombeve, parasheh dëmshpërblim “për shtetet që mund të dëmtohen” në këto raste⁴⁰. Edhe ministri fuqiptotë shqiptar në Londër Fuad Asllani, në prag të kthimit në Shqipëri ku do të merrte postin e ministrit të Jashtëm në qeverinë e re, e pa të nevojshme që të takohet me homologun jugosllav atje. Ai, përveç argumenteve standarde, e vuri theksin në faktin se Shqipëria “në aspektin ekonomik është gati tërësisht e orientuar kah Italia”⁴¹.

Përçapjet e palës shqiptare për mesazhe mirëkuptimi dhe bindjeje se Shqipëria mbron fuqishëm pavarësinë e saj dhe miqësinë me fqinjët, nuk sollën rezultat. Kjo kuptohet nga shkresat diplomatike të dala nga kabineti i M. Stojadinoviq. Më kuptimplota ndër to ishte shkresa me

³⁷ Mbreti Zog u tregua i pasigurt, sërish ndryshoi kurs.

³⁸ Martinac në cilësinë e ish drejtorit të Sektorit Politik në MPJJ, ishte bashkëbiseduesi kryesor i Ficos gjatë periudhës së afrimit shqiptaro-jugosllave (dhjetor 1933-gusht 1935)

³⁹ *AMPJ*, V. 1935, D. 79, fl. 110. Raport i ministrit Fuqiptotë shqiptar në Jugosllavi, Beograd, 14 tetor 1935.

⁴⁰ *Po aty*.

⁴¹ *DASSIP*, LP, 1935, F-I, Arb., nr. 825. Raport i ministrit Fuqiptotë jugosllav në Britaninë e Madhe, Londër, 24 tetor 1935.

instruksione drejtuar ministrit fuqiptotë jugosllav në Londër dhe atij në Paris. Duke u nisur nga informatat lidhur me bisedimet Tiranë-Romë për një hua prej 6.000.000 fr. ari dhe për kushtet e saj⁴² si dhe nga deklarata refuzuese shqiptare ndaj sanksioneve për motive politike, Stojadinoviçi nxirrte përfundimin se “1/ Shqipëria nuk e ka lirinë e duhur vendimmarrëse për çështje ndërkombëtare; 2/ Që Italia duke i dhënë sërish përkrahjen financiare Ahmet Zogut dhe regjimit të tij, ka për qëllim një mbështetje sa më të madhe dhe të sigurt nga ana shqiptare në rast të komplikimeve më serioze me Anglinë lidhur me konfliktin për Abisininë, dhe përgjithësisht për komplikimet si pasojë e zbatimit të sanksioneve të aprovuara nga Lidhja e Kombeve”⁴³. Në qoftë se e gjithë kjo realizohej, çka nënkuptonte nënshtrim të plotë të Shqipërisë nga Italia, kjo doemos do të krijonte “një situatë të re në marrëdhëniet tona me Italinë”-konstatonte Stojadinoviçi. Në këtë rast, Beogradi do të detyrohej që të njoftonte Fuqitë e Mëdha për këtë politikë të Italisë në Shqipëri, “e cila do të drejtohej kundër sigurisë së shtetit tonë dhe paqes në Ballkan”. Por, megjithatë, Stojadinoviçi shfaqte bindjen se Italia, në kontekstin e dhënë, nuk ishte e interesuar për zgjerim konflikti as në Ballkan dhe as në Evropë⁴⁴. Instruksionet për Gruiqin kishin pikësynim që të dërgoheshin në Britaninë e Madhe mesazhe se kush ishte aleatja e kush kundërshtarja e saj në konfliktin eventual me Italinë. Londra duhej të bindej se “Shqipëria e Ahmet Zogut” po shndërrohej në një satelit italian dhe si e tillë ajo paraqiste rrezik për paqen në Ballkan e më gjerë.

⁴² *Po aty*, LP, 1935, F-I, Arb., nr. 841, Beograd, 16 tetor 1935. Kushtet e huasë sipas Stojadinoviçit ishin: “1/ Obligimi i Shqipërisë që mos të aderoj në Paktin Ballkanik; 2/ Kontrolli i plotë i Italisë në shfrytëzimin e huasë. 2/ Koncesion i përkohshëm i shfrytëzimit të disa pikave në jug (Karaburuni, Treporta), ose e drejta e Italisë për zbarkim të forcave në këto pika në mënyrë që të pamundësojë ardhjen eventuale të flotës britanike në portet shqiptare. Me këtë favor Italia do ta mbyllte plotësisht detin Adriatik; 4/ Për sigurimin e kësaj baze në Vlorë, sipas të gjitha gjasave, Italia ka kërkuar nga qeveria shqiptare mobilizimin e shtatë klasave rezervistësh, të cilët do të mbronin dhe kufijtë me Greqinë dhe me mbretërinë tonë; 5/ Shqipëria përkundër mohimit nga qarqet zyrtare, iu ka lejuar italianëve vazhdimin e punëve për fortifikimet e Milotit, Librazhdit të Elbasani dhe në Burrel, me qëllim mbrojtjeje në rast të depërtimit eventual tonë drejt Tiranës”.

⁴³ *Po aty*.

⁴⁴ *DASSIP*, LP, 1935, F-I, Arb., nr. 841. Letër cirkulare e Kryeministrit dhe ministrit të Jashtëm jugosllav, Stojadinoviçi, drejtuar përfaqësive jugosllave në qendrat e mëdha botërore, Beograd, 16 tetor 1935.

Edhe në takimet që Martinac dhe Stojadinović patën me ministrin Fuqplotë britanik në Tiranë Hodgson, i cili gjatë rrugës për në Shqipëri u ndal në Beograd, theksuan se pozicionimi i Shqipërisë ndaj sanksioneve është tregues për varësinë e saj ndaj Italisë⁴⁵. Ndërsa, ministrit Fuqplotë britanik në Beograd raportonte se refuzimi i Shqipërisë për zbatimin e sanksioneve, kishte fundosur edhe shpresën e fundit “që Shqipëria të mund të bëhej faktor i pavarur...”⁴⁶. Ky konstatonte se që nga ky moment kreu jugosllav e konsideronte mbretin Zog si vasal të bindur të Italisë⁴⁷.

Një tiradë njëorëshe e ministrit Fuqplotë jugosllav në Athinë në takimin me homologun shqiptar atje, hedh dritë mbi një ndër opsionet politike jugosllave të bazuar në probabilitetin e dobësimit të Italisë. Sipas tij, fakti që Italia po dobësohej dhe pra po defaktorizohej, hapte rrugë për një “federatë ballkanike natyrisht nën hegjemoninë e Jugosllavisë”⁴⁸. U përmendën dhe hekurudhat deri në kufijtë e Shqipërisë, me ç’rast kjo do të përfitonte nga “trafikun ndërkombëtar”⁴⁹ etj. Në fakt, synimi dhe kërkesa konstante e Beogradit deri në vitin 1937, ka qenë që Italia, me dashje ose pa dashje, të pajtohej me hegjemoninë e tij në Ballkan, premisë kjo për miqësi e partneritet të qëndrueshëm ndërmjet dy vendeve.

Duhet thënë se shtypi jugosllav kësaj radhe ishte më korrekt në shkrimet lidhur me çështjen në fjalë dhe për Shqipërinë në përgjithësi. Ai u kufizua kryesisht në deklaratat e ministrit Fuqplotë shqiptar Fico në Beograd, duke potencuar se Shqipëria edhe më tej do të vazhdonte marrëdhëniet e mira dhe miqësore me shtetet fqinjë⁵⁰. Në shikim të parë, duket sikur në këtë qëndrim kanë ndikuar raportet e atasheut jugosllav për shtyp në Shqipëri, Deniq. Në një raport për qendrën informative jugosllave, ai nxirrte përfundimin se Shqipëria ka qenë e detyruar të distancohet nga zbatimi i sanksioneve “për shkak të varësisë nga Italia, e cila e ka ndihmuar financiarisht dhe ekonomikisht”⁵¹. Por në fakt, ky

⁴⁵ *The National Archive of London* (më tej: TNA), Foreign Office (FO) 371/19477, R 6724/889/90. Raport i Hoxhsonit drejtuar Samuel Hoare-s, Durrës, 6 nëntor 1935.

⁴⁶ *Po aty*, FO 371/20436, R 2165/2165/92. Raport vjetor i ministrit Fuqplotë britanik në Beograd.

⁴⁷ *Po aty*.

⁴⁸ *AMPJ*, V. 1936, D. 60, fl. 1-3. Raport i ministrit Fuqplotë shqiptar në Greqi, Athinë, më 30 dhjetor 1935.

⁴⁹ *Po aty*.

⁵⁰ *Politika*, Beograd, 15 tetor, 28 tetor 1935; *Vardar*, Shkup, 28 tetor 1935.

⁵¹ *AJ*, CPB (38-21-62). Atasheu për shtyp në Tiranë Deniq, 4 dhjetor 1935.

qëndrim i shtypit jugosllav krejt i ndryshëm nga ai i gusht-shtatorit (Kryengritja e Fierit dhe menaxhimi i saj), ka të bëjë me instruksionet nga lart. Konkretisht, të vetë kreut të qeverisë jugosllave, Stojadinoviq. Ai udhëzonte që Beogradi me asgjë nuk duhej t'i jepte shkas Italisë “për asnjë lloj gjesti armiqësor ndaj nesh”⁵². Një paralajmërim i hershëm për një kurs të ri politik jugosllav drejt një aleance me Italinë.

Përkundër jugosllavëve, grekët u treguan më se paqësorë. Edhe kryeministri Kondili po dhe ministri i Jashtëm Theotokis, mirëkuptonin qëndrimin e Shqipërisë ndaj sanksioneve dhe këtë veprim e konsideronin krejt të natyrshëm. Madje, kryeministri grek Kondili shprehu simpati ndaj shqiptarëve dhe rolit të tyre “për lirinë dhe independencën e Greqisë”⁵³. Natyrisht Athina ishte e kënaqur me epilogun e çështjes së shkollave minoritare në Shqipëri. Këtë “qëndrim miqësor” grek, ministri Fuqiplotë shqiptar, Xh. Leskoviku e vlerësoi si rast oportun që të shtronte dhe çështjen e hapjes së shkollave shqipe për minoritetin shqiptar si dhe çështjen e pasurive të shqiptarëve në Greqi⁵⁴.

Shfajësimi në Londër

Për Tiranën, rëndësi parësore kishte zbutja e qëndrimit britanik apo dhe ndonjë lloj mirëkuptimi nga kjo anë për pozicionin shqiptar ndaj sanksioneve. Kjo jo vetëm për shkak të peshës që kishte Londra në politikat ndërkombëtare por edhe për faktin se ajo mbante flamurin e këtyre sanksioneve. Në fillim, diplomacia shqiptare po e shihte me mirëdashje angazhimin e Britanisë kundër kërkesave italiane ndaj Etiopisë. Argumenti britanik se integriteti i anëtarëve të Lidhjes së Kombeve nënkuptohej dhe duhej mbrojtur, pasi formonte precedencë, dhe “në të ardhmen do të mund të invokohej në rast nevoje”⁵⁵ - theksohej nga përfaqësia shqiptare në Londër.

Diplomati shqiptar Mehmet Konica*, në takimet që pati në Forin Ofis, nuk u ndal vetëm në argumentet e përkufizuara në formulën zyrtare

⁵² *DASSIP*, LP, 1935, F-I, nr. 841, Arb., Beograd, 16 tetor 1935.

⁵³ *AMPJ*, V. 1935, D, 79, fl. 118. Raport i ministrit Fuqiplotë shqiptar në Greqi, Athinë, 25 tetor 1935.

⁵⁴ *Po aty*.

⁵⁵ *AMPJ*, 1935, D, 95, fl. 72-73. Raport i ministrit Fuqiplotë shqiptar në Britaninë e Madhe, Londër, 30 maj 1935.

* Ky diplomat njihet për orientimin e tij për Ballkanin paqësor dhe të bashkuar.

të Shqipërisë lidhur me qëndrimin e saj ndaj sanksioneve. Ai u përkujtoi britanikëve dhe “bashkëpunimin” e Shqipërisë lidhur me shkollat minoritare greke⁵⁶ si dhe lojalitetin e saj ndaj Lidhjes së Kombeve. Shqipëria ishte pjesë e atyre pak shteteve që kishte kryer plotësisht obligimet financiare ndaj Lidhjes së Kombeve⁵⁷. Përkundër kësaj, në Ministrinë e Jashtme britanike u shpreh pakënaqësia “që Shqipëria kundërshtoi sanksionet”⁵⁸, po dhe habia se po mungonte informacioni për ndonjë takim Eden-Frashëri në Gjenevë. Dhe në fund, Konicës iu shtrua pyetja delikate lidhur me qëndrimin e Shqipërisë ndaj cilësimit të Italisë si agresore, gjë që përligjte edhe masat adekuate kundër saj⁵⁹. Formulimi se cilësimi i Italisë si agresore ishte përcjell “me heshtje” nga ana shqiptare, e vështirë të kishte ndonjë efekt. Ministri Fuqiplotë britanik në Athinë, ia bëri me dije homologut të tij shqiptar Leskovikut, se qëndrimi shqiptar ndaj sanksioneve do të kishte implikime në çështjen e përkrahjes së Shqipërisë nga Lidhja e Kombeve në rast “të një konflikti e turbullimi...”⁶⁰. Një paralajmërim ky për qëndrimin e mëvonshëm të kësaj organizate ndërkombëtare po dhe të Britanisë, ndaj pushtimit të Shqipërisë në vitin 1939.

Por, sa korrektësi kishte në këtë qëndrim britanik ndaj Shqipërisë, kur dihet pozicionimi i Londrës ndaj synimeve të këtij shteti që me ndihmën e Jugosllavisë dhe Paktit Ballkanik të sillte në suaza normale marrëdhëniet me Italinë⁶¹. Londra ndërhyri haptas në Beograd duke kërkuar nga qeveria jugosllave që të hiqte dorë nga përkrahja e synimeve emancipuese të Shqipërisë⁶². “Qeveria jugosllave do të vepronte me urtësi po qe se nuk bënë asnjë propozim, dhe po ashtu nëse nuk përfillë propozimet shqiptare, sepse çfarëdo interesimi i treguar për ta, do të

⁵⁶ Çështja e shkollave “minoritare”, në fakt çështja e shkollave të huaja si kontekst shqiptaro-grek vazhdoi për një kohë të gjatë dhe mori zgjidhje në vitin 1935.

⁵⁷ *AMPJ*, V. 1935, D. 95, fl. 70. Raport i ministrit Fuqiplotë shqiptar në Britaninë e Madhe, Londër, 30 maj 1935.

⁵⁸ *Po aty*, V. 1935, D. 79, fl. 69. Raport i ministrit Fuqiplotë shqiptar në Britaninë e Madhe, 13 tetor 1935.

⁵⁹ *Po aty*.

⁶⁰ *Po aty*, fl. 137. Raport i ministrit Fuqiplotë shqiptar në Greqi, Athinë, më 13 nëntor 1935.

⁶¹ Për këtë shih: E. Arifi-Bakalli, *Marrëdhëniet ekonomike shqiptaro-jugosllave (1929-1939)*

⁶² Për këtë shih te: Emine Arifi-Bakalli, *Përballje Historiografike*, Instituti Albanologjik, Prishtinë: 2015, f. 77-89.

mund të interpretohej keq nga Roma, dhe njëkohësisht do të zgjonte shpresa të rrejshme në Shqipëri, e së cilës në atë rast askush më nuk do të ishte i gatshëm t'i jepte hua...⁶³ - thuhej në kërkesën britanike drejtuar Beogradit. Madje, Londra kërkoi që Beogradi të mos përkrahë Shqipërinë as në rast se ajo i drejtohej për ndihmë financiare Lidhjes së Kombeve⁶⁴.

Burimet “gjermane”, sipas ministrit Fuqiplotë shqiptar në Athinë⁶⁵ edhe kësaj radhe shprehnin dyshime në miqësinë britanike ndaj Shqipërisë. Madje, sipas tyre, Britania dhe Jugosllavia kishin trajtuar mundësinë e shkaktimit të “turbullimeve” në Shqipëri dhe se për këtë qëllim së shpejti atje do të arrinin misionarë britanikë nën petkun e turistëve⁶⁶.

Legata shqiptare në Britaninë e Madhe nisi të vinte në pah informacionet që zbutnin shijen e keqe lidhur me qëndrimin shqiptar ndaj sanksioneve. U konstatua se një pjesë e shtypit britanik e publikoi deklaratën e rastit të M. Frashërit pa koment. Madje, kishte dhe prirje që të mirëkuptohej ky veprim pasi Shqipëria ishte “ndër të paktat shtete që kishte përmbushur plotësisht kontributet ndaj Lidhjes së Kombeve...⁶⁷”. Kurse kryetari i Komitetit Ballkanik dhe mik i Shqipërisë Eduard Bojll, e arsyetonte qëndrimin e Shqipërisë duke theksuar “se ajo nuk kishte rrugë tjetër mbasi 40% të eksportit të Shqipërisë shkonte për Itali...”. Madje, sipas tij, Shqipëria duhej të admirohej që përkundër “gjithë vështirësive objektive të jashtme e të brendshme ka arritur të krijohet si shtet që nga themelet⁶⁸”.

Mirëkuptimin për veprimin e shqiptarëve e kishte shprehur dhe ministri Fuqiplotë turk në Londër, Feti Bej - “mik i shqiptarëve”, në një

⁶³ TNA, FO 371/18341, R 2465/90. Raport vjetor 1934, i ministrit Fuqiplotë britanik N. Henderson.

⁶⁴ Po aty, FO 371/18341, R 2465/90. Raport vjetor 1934, i ministrit Fuqiplotë britanik në Beograd N. Henderson. Njëkohësisht e kishte këshilluar protagonistin kryesor për afrim me Shqipërinë, mbretin Aleksandër, që Jugosllavia mos të merrte përsipër që të përkrahë Shqipërinë në rast se ajo i drejtohej Lidhjes së Kombeve për ndihmë financiare, madje që edhe vetë Beogradi mos t'i japë ndihmë financiare, në mënyrë që mos të plotësoheshin “dëshirat” e mbretit Zog.

⁶⁵ AMPJ, V. 1935, D. 79, fl. 137. Raport i ministrit Fuqiplotë në Athinë, Xh. Leskoviku, Athinë, 13 nëntor 1935.

⁶⁶ Po aty.

⁶⁷ AMPJ, V. 1935, D. 79, fl. 69-72. Raport nga legata shqiptare në Britaninë e Madhe, 13 tetor 1935.

⁶⁸ Times, Londër, 26 tetor 1935; Besa, Tiranë, 6 nëntor 1935.

bisedë me përfaqësuesin shqiptar në një pritje tek një aristokrat irlandez. Ndërsa disa diplomatë të tjerë kishin deklaruar se kështu Shqipëria evitoi “një vetëvrasje”, kurse disa syresh shprehën besimin se Shqipëria duhej të kishte pasur “arsye për një veprim të tillë”⁶⁹.

Zëra përkrahës për Shqipërinë u dëgjuan edhe në shtypin evropian. Në *Journal Des Nations*, potencohej nevoja që kishte Shqipëria për ndihmën italiane si pasojë e mungesës së kësaj ndihme nga anë të tjera. Madje, kjo kthesë e Tiranës u vlerësua si fund i ëndrrës jugosllave për “nashe more” dhe favorizim i asaj italiane për “mare nostrum”⁷⁰.

Mund të përfundojmë se qëndrimi i Shqipërisë ndaj sanksioneve kundër Italisë nga Lidhja e Kombeve dhe refuzimi i saj që t’i bashkëngjitet bllokadës “tragji-komike”, nuk kishte të bënte aspak me një “(kthim) nderi Italisë”⁷¹ siç e gjejmë te ndonjë autor italian. Apo dhe që ky qëndrim i Shqipërisë kishte të bëjë me natyrën e Mbretit Zog, i cili me çdo çmim mbronte pushtetin e tij duke rrezikuar jo vetëm Shqipërinë po dhe Ballkanin, siç e gjejmë te disa historianë shqiptarë. Duke u nisur nga këto konstatime subjektive dhe thjeshtëzuese, herë-herë del sikur Shqipëria ishte delja e zezë në mesin e të bardhave ballkanike, ku shquhej bardhoshja Jugosllavi⁷².

Kthesa jo e butë⁷³ po e fortë e Shqipërisë në rastin e sanksioneve ndaj Italisë, diktohej nga faktorë të brendshëm (mundësia e një kolapsi shtetëror), e sidomos nga faktorët e jashtëm, përkatësisht mbyllja e çdo shtegu për t’u shkëputur nga sfera e interesit italian. Në furtunën që po e mbërthente Evropën, Tirana u gjet para çështjes së mbijetesës si subjekt aktiv ndërkombëtar? Apo thënë ndryshe, para sfidës si të mbijetonte si

⁶⁹ AMPJ, V. 1935, D. 79, fl. 71. Raport nga legata shqiptare në Britaninë e Madhe, 13 tetor 1935.

⁷⁰ *Journal Des Nations*, Gjenevë, 25 tetor 1935.

⁷¹ Indro Montanelli, *Shqipëria një dhe njëmijë*, Tiranë: UEGEN 2004, f. 110. “I erdhi radha, më pas Shqipërisë t’ia kthejë nderin Italisë duke refuzuar prerazi (!-unë) t’i bashkëngjitej bllokadës tragjikomike të sanksioneve të Gjenevës”, - shprehet ky autor me ironi.

⁷² Prof. A. Puto konstaton se qëndrimi i Shqipërisë ndaj sanksioneve u bë shkak i ndërprerjes së bisedimeve (!-unë) me Jugosllavinë për aderimin e Shqipërisë në Paktin Ballkanik, gjë që drejtpërsëdrejti fajëson Shqipërinë. Por sa qëndron kjo kur dihet cili ishte qëndrimi i anëtareve të Paktit Ballkanik ndaj kësaj kërkesë të Shqipërisë dhe se çarja jugosllavo-shqiptare kishte ndodhur para kësaj ngjarjeje. (A. Puto, *Shqipëria politike (1912-1939) ...*, f. 534); Paskal Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë*, vëll. I, Tiranë: Toena, 2013, f. 842.

⁷³ Cilësim të cilin e gjejmë te P. Milo, *Politika e Jashtme...*, f. 842.

lojtar aktiv në lojën e koklavitur të diplomacisë ndërkombëtare, në mënyrë që në epilogun e saj të ndahej fati me lojtarët e tjerë. ”Ne bëmë përpjekje të vinim në një mirëkuptim me Italinë, sepse politika ndërkombëtare nuk na la asnjë zgjidhje tjetër...”⁷⁴ - iu përgjigj mbreti Zog një pyetjeje të një gazetari shumë vite më vonë.

S u m m a r y

ALBANIA’S ATTITUDE TOWARDS THE LEAGUE OF NATIONS’ SANCTIONS ON FASCIST ITALY (1935), AN OCCASION TO PROMOTE THE TRADITIONAL POLICY OF YUGOSLAVIA

One of the last acts in the mission of the League of Nations was the imposing of sanctions to Fascist Italy (1935) after the latter attacked Ethiopia. However, the way these sanctions were carried out or more accurately giving up such sanctions even before they started to be implemented, was a clear warning for all the political actors of the time. It was about to begin the era of surviving policies and backing up in front of aggressive threats coming from the European extreme right wing.

Albania resulted to be among the countries which were to be tested the most with regards such sanctions. The inclination and the long term interests meant that Tirana should remain loyal to the Convention of the League of Nations, according to which defensive measures were to be taken in case one of its members was to become victim of a classic aggression (Article 16). But on the other hand, the political crisis of the summer 1935 was not over yet, while the economic crash was practically leading her towards a state collapse. Lacking support of any kind, the Albanian leader decided to turn to surviving policies, declaring his refusal to implement such sanctions.

The Yugoslav government headed by Stojadinovic, took advantage of this fact to promote once again the traditional policy of Belgrade towards Albania. The essence of such policy was to target and label Albania as an unstable and dangerous country for the peace of the Balkans and beyond.

⁷⁴ TNA, FO 371/33111, R 6119; *Manchester Guardian* (12 shtator 1942); “Por megalomania e regjimit fashist na bëri të sigurt se një ditë ne do të duhej të luftonim, për të mbrojtur veten. Çështja ishte që krizën tonë ta bënim që të koïncidonte me krizën e përgjithshme evropiane. Ne pothuajse patëm sukses”. Ana Lalaj, *Dosjet e Luftës*, Tiranë: Toena, 2014, f. 46; Owen Pearson, *Albania in Occupation and War, 1940-1945*, The Centre For Albanian Studies, London: 2005, f. 204.